

**Dr. Ardit BIDO**

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave

## **DIXHITALIZIMI SIPAS KËRKESËS: RASTI I AQSH TË RSH**

**Abstrakt:** *Epoka e teknologjisë së informacionit kërkon një përshtatje të re edhe të arkivave. Ajo mundëson që ruajtja dhe shërbimi i dokumenteve të kryhet më mirë dhe më shpejtë. Prandaj, orientimi ndaj TIK duhet të jetë një prioritet i padiskutueshëm i çdo arkivi. Në këtë kumtesë do të trajtohet strategjia e re të dixhitalizimit që ka nisur zbatimin në AQSH, modelet më të mira ndërkombëtare në këtë fushë si edhe metodikën e zbatimit të digjitalizimit masiv, përfshi këtu edhe përsbkrimin arkivor sipas standardit ndërkombëtar ISAD(G). Ajo do të prezantojë format e larmishme të digjitalizimit në AQSH, si edhe forma të tjera që aplikohen në vende evropiane, duke marrë parasysh edhe përparësitë dhe kosto-efektivitetin e zbatimit të tyre.*

**Fjalët kyçe:** *digjitalizim, AQSH, ISAD(G), arkiv.*

### **Hyrje**

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave përmban më shumë se 25 kilometra linearë dokumentacion të Arkivit Qendror Shtetëror dhe Arkivave Shtetërore Vendorë. Numri total i fletëve është i pamundur të përllogaritet me saktësi, por mund të thuhet me bindje se janë më shumë se 300 milionë fletë në origjinalin e tyre që përbëjnë pasurinë më të madhe material kombëtare.

Strategjia e digjitalizimit që është vendosur në zbatim këtë vit në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave është frymëzuar nga një numër strategjish të arkivave evropiane dhe më gjerë, përfshi, e veçanërisht, strategjinë e Arkivit Kombëtar në Britaninë e Madhe, të Shteteve të Bashkuara, të vendeve baltike, si edhe të vendeve fqinje që kanë përparuar në këtë drejtim si Sllovenia, Rumania dhe Turqia.

### **Gjendja aktuale në AQSH dhe sfidat**

Numri total i dokumenteve të skanuara në DPA, përpara hyrjes në veprim të qasjes së re që do të sqarojmë më poshtë, ka qenë 600.000 dokumente të skanuara, përgjatë një periudhe 10 vjeçare, asnjë prej të cilave nuk ishte e indeksuar dhe e përshkruar sipas standardeve arkivore ndërkombëtare, veçanërisht ISAD(G). Nga ana tjetër, skedimet e fundit të organizuara kanë ndodhur në vitin e largët 2004 dhe skedime më sporadike deri në vitin 2012, por të gjitha në formë në letër, duke mos u përshtatur me prirjen e re të përshkrimit të dokumenteve në sistemet kompjuterike, që lehtëson punën e kërkuesit.

Edhe pse sistemi elektronik ScopeArchiv ka qenë pjesë e DPA prej vitit 2009 dhe është on-line prej vitit 2017, ai nuk ka përshkrim arkivor të dokumenteve, por inventarin e plotë elektronik të Arkivit Qendror Shtetëror. Në të janë hedhur edhe një pjesë e skedarëve si njësi brenda dosjeve. Mirëpo, nuk është përdorur asnjë element që të jep teknologjia për treguesit e ndryshëm që mund të plotësoheshin, në mënyrë që të mund të ndërthureshin automatikisht metadat, për të nxjerrë kërkime bazuar në këta tregues. Skedat janë kopjuar në formë elektronike me besnikëri të formës fizike, pa plotësuar metadat që mundësojnë ndërveprimin e sistemit elektronik.

### **Digjitalizimin sipas kërkesës (on demand)**

Përballë kësaj situatë të trashëguar, DPA ka zgjeruar qasjet e digjitalizimit në tre drejtime të ndryshme, duke ia dalë që të dyfishojë numrin total të dokumenteve të skanuara për dhjetë vjet, në vetëm pak muaj, si edhe planifikon 30 fishimin e normës totale të dokumenteve të skanuara përgjatë një viti. Mbi të gjitha, kjo qasje nuk cenon buxhetin total të institucionit, por është kryer me mjetet që janë në dispozicion. Strategjia ka tre qasje kryesore: Digjitalizimin sipas kërkesës (on demand); Digjitalizimin nga partnerët vendas; Digjitalizimin sipas prioriteteve.

Digjitalizimi sipas kërkesës (on demand) nisi përgjatë muajit qershor, ku numri total i dokumenteve të skanuara përgjatë një viti do të jetë 20 herë më i lartë sesa ishte numri kur kjo punë kryhej nga vetë institucioni, me një raport 1:3 të kostos, në favor të këtij projekti. Kjo qasje mundëson që shumica e dokumenteve të kërkuesve përmes paracaktimit të vizitës në

sallën e studimit, do të ofrohen në format elektronik përmes aplikacionit on-line. Më konkretisht, studiuesi do të duhet të plotësojë formularin on-line duke porositur dosjet që dëshiron të shohë dhe ditën që ka caktuar vizitën në sallën e studimit do të hyjë me kartën e tij elektronike në kompjuterat e sallës, ku do të jenë hedhur të skanuara dosjet që ka kërkuar të studiojë pa pagesë.

Procedura që ndjek arkivi është që dosjet e kërkuara për një datë të caktuar t'i skanojë një ditë përpara, përmes kapaciteteve të reja skanuese të saj. Përmes kësaj qasjeje, norma ditore e skanimit është rritur nga 600 në 11701 dokumente në ditë. Thënë ndryshe, në dhjetë ditë pune skanohen po aq dokumente sa skanoheshin në një vit deri para pak kohësh, brenda kapaciteteve financiare që ka pasur DPA, pa kosto shtesë për buxhetin e shtetit.

Kjo qasje ka disa veçori pozitive njëkohësisht. Ajo arrin që të shumëfishojë numrin e dokumenteve të skanuara, duke rritur kapacitetet dhe novacionin në DPA. Së dyti, arrin që të plotësojë kërkesat e studiuesve, duke skanuar dosjet më të kërkuara (on demand) dhe jo me përzgjedhje nga vetë stafi i arkivit. Së treti, dhe më kryesorja, mundëson ruajtjen fizike të arkivit, teksa dosjet do të preken vetëm një herë me dorë, pasi pas skanimit të tyre do të përdoret vetëm varianti i skanuar në vijimësi. Po ashtu, përmes këtyre kapaciteteve dhe kësaj qasjeje, mundësohet edhe blerja on-line e kopjeve të skanuara të dosjeve, duke paguar koston përkatëse.

### **Qasjet e tjera dhe përshkrimi arkivor në sisteme digjitale**

Qasja e dytë e digjitalizimit është përmes partnerëve lokalë, të cilët kanë interesin për të digjitalizuar fonde të plota dokumentare të gjendura në AQSH dhe ASHV. Kjo qasje parashikon skanim të plotë të fondeve, në ndryshim nga digjitalizimi sipas kërkesës, ku përzgjedhja e njësisve të ruajtjes që skanohen bazohet mbi kërkesat individuale të studiuesve. Digjitalizimi përmes partnerëve është i mundshëm në rastin kur partneri lokal ka një interes konkret dhe lidhje të ngushtë me fondin arkivor. Deri më tani janë skanuar, përmes kësaj qasjeje, të gjitha fondet e Komunitetit Mysliman, Komunitetit Bektashi dhe Kryqit të Kuq Shqiptar nga institucionet respektive. Po ashtu, pritet që edhe Komuniteti Ortodoks dhe Komuniteti Katolik të skanojnë dokumentet e tyre, një proces që ka mbetur pezull deri në sigurimin prej tyre të skanerave profesionalë dhe punonjësve që do të kryejnë këtë

punë. Së fundmi, përmes marrëveshjes me Arkivin Osman të Stambollit janë skanuar të gjitha dokumentet në gjuhë osmane që gjenden në DPA. Përmes kësaj qasjeje, deri më tani janë skanuar mbi 500.000 dokumente ose, thënë ndryshe, po aq dokumente sa kanë qenë të skanuara për 10 vjet.

Qasja e tretë që pritet të aplikohet gjatë këtij viti në DPA është digjitalizimi sipas prioriteteve. Deri më tani janë digjitalizuar dokumente të rëndësishme që gjenden në AQSH, si Kodet e Beratit dhe disa dhjetëra dorëshkrime të rralla të kujtesës sonë kolektive kombëtare. Po ashtu, janë digjitalizuar dokumente pronësore që gjenden në AQSH. Brenda vitit, DPA do të pasurohet me katër skanerë të rinj profesionalë që do të përdoren për skanimin e dokumenteve pronësorë dhe biografikë (amza shkollore, vendime punësimi, etj.) që gjenden në Arkivat Shtetërore Vendore. Kjo qasje mundëson shërbimin më të shpejtë të qytetarëve për kërkesat social-juridike, por edhe rritjen e sigurisë së dokumenteve që kanë sensitivitet të lartë në përditshmërinë e shqiptarëve.

Një qasje e katërt që përdoret në pak vende të Evropës, por që ia vlen të merret parasysh, është digjitalizimi vullnetar. Kjo qasje përdoret në Estoni dhe Finlandë dhe parasheh një formë “shkëmbimi në natyrë” mes studiuesve dhe arkivave. Studiuesit mund të kërkojnë skanimin e një dokumenti, përmes pagesës, ose mund të skanojnë personalisht të gjithë njësinë e ruajtjes, ta ngarkojnë në sistemin on-line dhe të marrin një kopje pa pagesë, përmes skanerave që gjenden në sallën e studimit. Kjo lloj qasje nuk po aplikohet në AQSH, por mund të merret parasysh në të ardhmen.

Rritja e kapaciteteve skanuese në përmasa të tilla mundëson që DPA të rifokusohet në rolin e vetë kryesor, që është ruajtja dhe shërbimi sa më efikas i dokumentacionit historik. DPA ka planifikuar që prej vitit të ardhshëm të rinisë procesin e përshkrimit të dokumenteve arkivore, këtë herë në sistem elektronik, që do të mundësonte një ndërthurje automatike të të dhënave, përmes treguesve që do të plotësohen në sistem. Të gjitha dokumentet e skanuara deri më tani ngarkohen në bazë ditore në sistemin ScopeArchiv, duke u lidhur me metadatat e njësive të ruajtjes ku ato bëjnë pjesë. Vitin e ardhshëm, sektorët e përpunimit të DPA do të nisnin plotësimin e metadatave unike për secilin dokument, në përputhje me standardet ndërkombëtare ISAD(G). Në këtë mënyrë, aksesimi do të jetë më i shpejtë dhe kërkimi për studiuesit më i lehtë.

## **Përfundime**

Si përfundim, në pesë vite DPA do të skanojë së paku 10 milionë dokumente, nga 100 mijë dokumente të skanuara në vitin më të mirë të 10 viteve të fundit. Këto qasje mundësojnë skanim të shpejtë dhe të plotë në mënyrë kosto-efektive, me bashkëpunim me partnerë lokalë, me sipërmarrës privatë dhe digjitalizim prioritar, pa ngarkesa të mëtejshme në buxhetin e vogël të DPA. Po ashtu, ekziston dhe një qasje e katërt e ndjekur në pak vende evropiane që mund të shihet si mundësi shtesë në të ardhmen. Së fundmi, i hap rrugën përshkrimit gradual të dokumenteve, që gjithsesi janë të aksesueshme përmes metadatave të njësive të ruajtjeve që gjenden në katalogun on-line.